

E DREJTA PËR INFORMIM

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar

E drejta e informimit është një e drejtë themelore që garanton transparencën e veprimtarisë së institucioneve publike dhe fuqizon qytetarët të kërkojnë llogari. Në Shqipëri, kjo e drejtë mbrohet nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, i cili përcakton detyrimet e autoriteteve publike për të siguruar akses në dokumentet dhe informacionin që ato mbajnë.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucioni i pavarur që mbikëqyr zbatimin e këtij ligji. Zyra e Komisionerit shqyrton ankesat e qytetarëve, merr vendime detyruese për autoritetet publike dhe luan një rol kyç në promovimin e një kulture transparence.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës.

Vendimmarrja e Zyrës së Komisionerit në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike si dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Vendimmarrja e Komisionerit synon të sigurojë barazi në qasjen ndaj informacionit dhe forcimin e besimit të publikut në administratën shtetërore.

Vendimmarrja e Zyrës së Komisionerit qershor - korrik 2025

Vendim Nr. 14 - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Vendim Nr. 17 - Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve

Vendim Nr. 18 - Bashkia Vlorë

Vendim Nr. 19 - Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Vendim Nr. 20 - Bashkia Cërrik

Vendim Nr. 21 - Shoqëria "Coca-Cola Bottling Shqipëria" Shpk

Vendimi nr. 14, datë 05.06.2025

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë muajve qershor - korrik 2025 ka dhënë 6 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Sipas Vendimit nr. 14, datë 05.06.2025, Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi, me anë të kërkesës së tij ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/ dokumentacioni, në lidhje me:

1. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2020.
2. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2021.
3. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2022.
4. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2023.
5. Listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” për programet e rindërtimit, për të cilat do të aplikohet përjashtimi nga TVSH për vitin 2024.

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it zyrtar, ka kthyer përgjigje duke cituar ndër të tjera se: “...Në lidhje me kërkesën ku kërkohet informacion lidhur me listën e kontratave me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 Administrata Tatimore bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 24 të tij ka përcaktuar shprehimisht autoritetet të cilave ka detyrimin e vënies në dispozicion të informacionit tatimor lidhur me tatimpaguesin, si dhe rastet e dhënies së këtij informacioni. Ndërsa në nenin 25 “Konfidencialiteti”, të ligjit të sipërcituar parashikohet se: “Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës.” Të dhënat e kërkuara përbëjnë të dhëna tatimore bazuar në nenin 31 “E drejta për konfidencialitetin e të dhënave”, pika 2 e ligjit të sipërcituar, ku përcaktohet se: “E dhënë tatimore dhe financiare është çdo informacion, i cili merret nga administrata tatimore gjatë ushtrimit të funksioneve, tek tatimpaguesit ose palët e treta”.

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk i është vendosur në dispozicion lista e kontratave

me emrat e kompanive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH-ja sipas ligjit nr. 97/2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për vitet 2020 – 2024, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”) dhe kërkoi nga Autoriteti Publik, të rivlerësojë dhënien e informacionit në raport me vendimmarrjen e Komisionerit për raste të ngjashme. si dhe në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv Komisioneri ftoi Autoritetin Publik në një seancë dëgjimore.

Përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në aktet shkresore të sipërcituara, si dhe deklaruan ndër të tjera se informacioni objekt shqyrtimi disponohet por jo në formatin e kërkuar. Pra, informacioni nuk disponohet në formën e një liste. Konkretisht përfaqësuesit deklaruan se kontratat dhe dokumentet shoqëruese disponohen nga Autoriteti Publik, por ato janë shumë voluminoze.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, qëndrimin të mbajtur nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Refuzimi i dhënies së informacionit, fillimisht mbi bazën e nenit 24 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është i gabuar, pasi ky ligj nuk parashikon ndalimin e dhënies së informacionit tatimor për subjekte të tjera mbi bazën e LDI.

Lidhur me argumentin e parashtruar në seancën dëgjimore nga përfaqësuesit e Autoritetit Publik se dokumentacioni i disponuar është voluminoz, Komisioneri vlerëson se ky qëndrim nuk vjen në përputhje me qëllimin e LDI.

Në këto kushte, bazuar në pikën 2, të neni 2 të LDI, ku parashikohet se: “Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”, Komisioneri vlerëson se, informacioni mbi kontratat përkatëse, përbën informacion publik dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara duhet të vendoset në dispozicion të kërkuarit/ankuesit në formatin e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të LDI.

Në përfundim, Komisioneri vendosi pranimin e ankesës dhe urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion. Vendimin mund ta lexoni të plotë në faqen zyrtare www.idp.al

Vendimi nr. 20, datë 04.07.2025

Sipas Vendimit nr. 20, datë 04.07.2025, Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Cërrik” me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi, me anë të kërkesës së tij ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion informacioni/ dokumentacioni, në lidhje me:

1. Sa ankande janë zhvilluar nga Bashkia Cërrik për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor (sip. me bimësi pyjore) për Agropylltari, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore që sot janë në fuqi?
2. Cilat sipërfaqe (parcela) konkrete janë dhënë?
3. Cilat subjekte apo individë janë shpallur fitues për secilin ankand?
4. Kopje të dokumentacionit të ankandit, ofertave, si dhe kontratave të lidhura me subjektet apo individët të shpallur fitues.

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje nga autoriteti publik, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën e tij. Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri nëpërmjet shkresës zyrtare ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion.

Autoriteti Publik, ka kthyer përgjigje Zyrës së Komisionerit duke sqaruar se: “...Konkurimi publik për dhënien me qera të sipërfaqes të fondit pyjor/kullosur bëhet: 1. Nëpërmjet shpalljes së njoftimit për konkurim publik për dhënien me qera të sipërfaqes të fondit pyjor/kullosur. 2. Njoftimi bëhet në Buletin e Prokurimeve Publike, i cili përmban të dhënat për sipërfaqen, aktivitetin, vendin dhe datën e orën e paraqitjes së dokumentacionit të kërkuara për këtë procedurë. 3. Komisioni i vlerësimit vendos për subjektin fitues të konkurimit dhe njofton shpalljen e fituesit në Buletin e Prokurimeve Publike. Pra, të gjitha të dhënat që kërkoni i keni në Regjistrin e Prokurimeve Publike...”. Ndërkohë me email-in e datës 09.06.2025, Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion linkun: <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=f104f9e0-cc30-4384-ae7a-aea1c6ffa521>.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, qëndrimin të mbajtur nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Konstatohet se Autoriteti Publik, në përgjigjen dhënë ankuesit, ka vendosur në dispozicion linkun e faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, i cili nuk përkon me objektin e kërkesës për informacion, në lidhje me çështjen e ankimit.

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit “Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokumentacion, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI.

Nga sa më sipër arsyetuar, Autoriteti Publik nuk ka përmbushur detyrimin për vendosjen në dispozicion të informacionit sipas kërkesës, depozituar nëpërmjet shërbimit postar me nr. dëftese 3007, datë 28.04.2025, në përputhje me parashikimet e LDI, edhe pas komunikimeve të vazhdueshme nga ana e Zyrës së Komisionerit, si dhe nuk ka paraqitur argumente në mbështetje të qëndrimit të tij.

Gjithashtu, detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njërive të qeverisjes vendore i'u lind edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar. Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar “Transparenca e veprimtarisë së njërive të vetëqeverisjes vendore”, parashikohet se: “1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”.


Në përfundim Komisioneri vendosi pranimin e ankesës dhe urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion, në formatin e zotëruar, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Vendimin mund ta lexoni të plotë në faqen zyrtare www.idp.al

Ligji për të dhënat e hapura, ekspertët ndërkombëtar asistencë teknike

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të projektit TAIEX ka zhvilluar online, takimin e parë me misionin e ekspertëve ndërkombëtar për fushën e të dhënave të hapura.

Në takimin e mbajtur mes përfaqësuesve të Zyrës së Komisionerit dhe ekspertëve u diskutua mbi detajet e aktivitetit që do të zhvillohet në muajin shtator mbi ligjin nr. 33/2022 “Për të Dhënat e Hapura dhe Ripërdorimin e Informacionit të Sektorit Publik”.



Ekspertët e huaj do të ofrojnë asistencë teknike dhe këshillimore për të vlerësuar kuadrin aktual ligjor dhe institucional, për të identifikuar sfidat praktike në zbatimin e ligjit dhe për të hartuar rekomandime për përmirësim.

Ky mision synon gjithashtu të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të administratës publike për të identifikuar, përpunuar, standardizuar dhe publikuar të dhënat në formate të hapura. Përmes takimeve me stafin e Zyrës së Komisionerit, palët kryesore të interesuara duke analizuar praktikën aktuale, ekspertët do të ndihmojnë në hartimin e udhëzimeve praktike, mekanizmave të monitorimit dhe masave për të inkurajuar ripërdorimin e të dhënave nga publiku ose organizata të tjera si biznese, institucione, apo për kërkime shkencore.